

Konventat, Deklaratat dhe dokumentet tjera përkatëse për të Drejtat e Njeriut

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (ECHR, 1950)

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD, 1965)

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (CCPR, 1966)

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESR, 1966)

Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW, 1979)

Konventa Kundër Torturës dhe Formave tjera të trajtimit apo dënimit johuman apo degradues (CAT, 1984)

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (CRC, 1989)



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

**Ndërtesa e PSHDNJ-së
rruga Rrustem Statovci nr. 29
Prishtinë**

Orari i punës
E mërkurë, e enjte
10.00-12.00

Tel +386- (0)43 78 2125
Fax +386- (0)38 78 7711

Email office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli për Shqyrtimin e Drejtave të Njeriut (PSHDNJ)

PSHDNJ përbëhet nga tre ekspertë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut. Z. Antonio Balsamo, shtetas italian, znj. Magdalena Mierzevska, shtetase e Polonisë dhe z. Francesco Florit, shtetas i Italisë. Mandati i PSHDNJ-së është shqyrtimi i shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i gjatë ushtrimit të mandatit të vet ekzekutiv. PSHDNJ është një organ i pavarur i cili kryen funksionin e tij me integritet dhe paanshmëri.

Juridiksioni

PSHDNJ shqyrton ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara që janë bërë nga 9 dhjetori 2008 në Kosovë..

Ankesa duhet të dorëzohet deri më 09.09.2010, gjegjësisht brenda gjashtë muajve nga data kur supozohet të jetë kryer shkelja, apo cilën datë nga këto dyja e preferon ankuesi.

Procedura

PSHDNJ shqyrton ankesat bazuar në informacionin e dorëzuar me shkrim. Gjithashtu mund të pranojë edhe informacione gojarisht.

Të Drejtat e Njeriut

Çdo personi i garantohen të drejta dhe liri të ndryshme themelore, si p.sh

- ✓ E drejta për jetë, liri dhe siguri të personit
- ✓ E drejta për seancë dëgjimore të drejtë brenda një kohe të arsyeshme
- ✓ E Drejta për mbrojtje nga tortura, trajtimi jo human dhe puna e detyruar
- ✓ E Drejta për respektim të jetës familja dhe privatësisë
 - ✓ E drejta pronësore dhe shëndetësore
 - ✓ Liria e Lëvizjes, mendimit, besimit
 - ✓ Liria për bashkim dhe shoqërim
 - ✓ Ndalimi i Diskriminimit

Ankuesi

Ankesa mund të parashtrohet nga çdo person, në përjashtim të stafit të EULEX-it i cili pandeh të ketë pësuar, të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it. Ankuesi mund të përfaqësohet në PSHDNJ nga avokati apo përfaqësues të tjerë që zgjedhin ata.

Ankesat

Ankesa plotësohet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankuesi. Duhet të përmbajë të gjithat detajet e kontaktit dhe faktet për shkeljen e pretenduar të shoqëruara me dëshmitë e nevojshme të dokumentuara. Nëse ekziston ndonjë vendim i mëhershëm mbi çështjen, atëherë edhe ato duhet bashkangjitur ankesës.

Të gjeturat

PSHDNJ dorëzon të gjeturat e veta Kryesuesit të Misionit dhe në rast nevojë bën rekomandime jo-obligative për veprimet pasuese korrigjuese.

Të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet bëhen publike.